



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 15.02.2022

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, në mbledhjen e datës 15.02.2022, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Aurora Mara.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm:

1. Znj. Edona Bilali – Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
2. Z. Eldi Çondi – Drejtor Kabineti;
3. Znj. Ana Petani – Specialiste per Startup-et dhe Inovacionin

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, ka si qëllim të përcaktojë kuadrin rregullator dhe institucional, i cili do të mbështesë e favorizojë krijimin dhe zhvillimin e *startup*-eve innovative dhe të ekosistemit në mënyrë që të krijohen kushte efikase për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve të reja, modeleve, produkteve apo forma operimi të cilat janë inovative për tregun dhe veçanërisht proceset teknologjike të reja, të cilat sjellin risi dhe progres në çdo fushë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet që të krijohen kushtet për dhënien e suportit dhe lehtësive për startup-et gjatë ciklit të jetës së tyre, duke filluar nga regjistrimi/krijimi i tyre dhe më pas në vijim gjatë fazës së zhvillimit dhe maturimit si dhe gjetjen e formave të duhura për ndërveprimin e startup-eve me ekosistemin e inovacionit.

Projektligji parashikon një kuadër të posaçëm normativ, i cili do i mundësojë startup-eve fitimin e një statusi ligjor, si dhe favorizon formalizimin e bizneseve ekzistuese duke filluar nga momenti i vetdeklarimit. Gjithashtu, ky projektligj është një instrument ligjor, i cili përcakton aktorët institucionalë të cilët do të sigurojnë unifikimin e procedurave dhe mekanizmat mbështetëse shtetërore për krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe të gjithë ekosistemit.

Nëpërmjet hartimit të këtij projektligji të ri, synohet që të realizohen disa objektiva, të cilat do të ndikojnë konsiderueshëm në krijimin e një terreni të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startupe-ve në treg, si më poshtë:

- Lehtësimin e procedurave dhe modaliteteve në krijimin, hyrjen në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së *startup*-eve;
- Krijimin e një konteksti pozitiv për tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve dhe të burimeve njerëzore;
- Të stimulojë potencialet e vendit tonë në fushën e inovacionit duke krijuar një kuadër të përshtatshëm rregullator të posaçëm;
- Krijimi i lehtësirave dhe mbështetje për të aksesuar në burimet financiare;
- Përfshirje sociale dhe diversiteti në mbrojtje të vlerave demokratike.

2.2. Përmbajtja e projektligjit

Projektligji është hartuar në 3 (tre) krerë dhe përmban 17 (shtatëmbëdhjetë) nene në total, të cilat kanë këtë përmbajtje:

- Në kreun I, “Dispozita të përgjithshme”, nga Neni 1 deri në Nenin 9, përcaktohen qëllimi, objekti i projektligjit, përkufizimet, parimet dhe format e mbështetjes së startup-eve, organet përgjegjëse e detyrat e ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes si dhe Këshilli i Startup-eve dhe detyrat e ministrive ose të institucioneve të tjera publike.
- Në kreun II “Mbështetja e Startup-eve”, nga Neni 10 deri në Nenin 15, parashikohen dispozitat rregulluese në lidhje me Startup-et, regjistrin e startup-eve dhe lehtësuesve, mbështetjen e startup-eve nëpërmjet ofrimit të shërbimit “*startup one-stop-shop*”, ekosistemit, lëvrimin të granteve dhe masave mbështetëse si dhe përcakton mënyrën e monitorimit të masave mbështetëse.
- Kreu III “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, Neni 16 dhe Neni 17, përmban dispozitat kalimtare në këtë projektligj dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij projektligji, si dhe hyrjen në fuqi të tij.

2.3 Risitë e projektligjit

Ky projektligj paraqet risitë e mëposhtme:

- Përfaqëson një akt ligjor të posaçëm për krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe ekosistemit, të cilat për nga karakteristikat kanë nevojë për një paketë ligjore unike e të veçantë.
- Rregullon mënyrën e regjistrimit të startup-eve, lehtësuesve, përmbajtjen e qëllimit e krijimit të regjistrin elektronik për të siguruar informacion të përditësuar për këto subjekte dhe të pranueshëm për aplikimin dhe përfitimin nga masat mbështetëse.
- Parashikon mënyrat e mbështetjes, duke theksuar kontributin e buxhetit të shtetit.
- Ndikon ndjeshëm në krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe adresimin e modeleve të biznesit tek inovacioni.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË KUSHTETUESE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE AKTET NDËRKOMBËTARE

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk transponon specifikisht *acquis* të Bashkimit Evropian, por zbaton parimet e EU Small Business Act, EU Startup Nations Standard dhe mekanizma analogë mbështetjeje të aplikuar nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të saj.

V. KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji është përgatitur me kontributin e grupit të punës i përbërë nga disa përfaqësues si: ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me asistencën teknike të GIZ-it, nëpërmjet projektit *EU for Innovation*. Pas procesit të konsultimit publik, komentet dhe sugjerimet nga palët e interesit, të shprehura gjatë konsultimit, janë reflektuar nga kabineti i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në bashkëpunim me Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Kryeministri.

VI. EFEKTET FINANCIARE

Miratimi i këtij projektligji do të shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit, që i përkasin kryesisht ngritjes së regjistrimit të portalit elektronik për startup-et. Kostoja ekonomike për ngritjen e këtyre dy sistemeve do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

VII. DISKUTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Për të prezantuar projektligjin në Komision ishte e pranishme znj. Znj. Edona Bilali, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Gjatë prezantimit, ministria Bilali referoi përpara komisionit çështjet kryesore dhe efektet e pritshme që synohen të arrihen nëpërmjet zbatimit të këtij projektligji, i cili ka në fokus krijimin e një kuadri ligjor nëpërmjet të cilit do të rregullohet statusi i startup-eve dhe ekosistemit mbështetës së tyre.

Ky ligj ka në fokus ofrimin e mbështetjes kundrejt startup-eve dhe ekosistemit si në shërbime/konsultime ashtu edhe me suport financiar nëpërmjet lëvrimin të granteve. Në hartimin e këtij ligji është synuar përdorimi i termave dhe dispozitave parashikuese të thjeshta në mënyrë që të kuptohet lehtë nga të gjithë të interesuarit, veçanërisht të rinjtë.

Gjithashtu, Znj. Bilali sqaroi procedurat e mbështetjes së startup-ëve dhe të ekosistemit, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera nëpërmjet ofrimit të shërbimit “*startup one-stop-shop*”.

Deputetja Aurora Mara, në cilësinë e relatorit, vlerësoi iniciativën e rëndësishme e miratimit të këtij projektligji dhe pasi prezantoi qëllimin, objektivat, efektet financiare dhe impaktin që pritet të sjellë implementimi i këtij projektligji, u kërkoi kolegëve ta miratojnë atë, duke u ndalur në disa pika të teknikës legjislativë, të cilat u dakordësuan paraprakisht me ministrinë nismëtare.

Në përputhje me rregullat e teknikës legjislative, relatori Aurora Mara sugjeroi konkretisht rregullimet e mëposhtme:

Neni 1 i projektligjit, fjala “krijimi” para togfjalëshit “kuadrit rregullator” të zëvendësohet me fjalën “hartimi”.

Neni 3 i projektligjit, prapa çdo përkufizimi në pikat a, b, c, ç e d, të shtohen sipas kuptimit, fjala “është” ose “janë” .

- Në shkronjën “ç” të nenit 3, togfjalëshi “puna e tyre kryesisht është puna lëvizëse” të zëvendësohet me togfjalëshin “punojnë kryesisht në distancë ose në lëvizje”;
- Tek shkronja “d” e nenit 3, për harmonizim me legjislacionin e zbatueshëm, para togfjalëshit “personi juridik ose fizik” të shtohet fjala “individ”.

Tek **Neni 7**, në harmoni dhe me Nenin 6 togfjalëshi “ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” të zëvendësohet me togfjalëshin “ministri përgjegjës”.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji dhe në përfundim të diskutimeve, nga kryetarja e komisionit znj. Klotilda Bushka, relatori dhe anëtarët e komisionit u theksua rëndësia e kësaj nisme, duke vlerësuar këtë projektligj si një hap konkret, i cili do të mundësojë rregullimin e kuadrit ligjor që do të stimulojë dhe nxisë krijimin e bizneseve të reja inovatore, kryesisht nga të rinjtë, të cilët do të kenë mundësi të gjejnë veten në tregun e biznesit.

VIII. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Në aktin e projektligjit, termat e tjera të shprehura në anglisht, të cilat mund t’u jepet/gjendet një kuptim në shqip, të shtohen tek neni 3 “Përkufizime” të projektligjit.

IX. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për t'ia përcjellë mendimin Komisionit përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

AURORA MARA

KLOTILDA BUSHKA